



UDHËZIM ADMINISTRATIV

Nr. 03/2005, Datë .02.2005

ZBATIMI I RREGULLOREVE TË UNMIK-ut Nr. 2002/3 DHE Nr. 2004/51

MBI TATIMIN NË FITIM

DHE

TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

Ministri i Financave dhe Ekonomisë,

Bazuar në autorizimin dhënë atij sipas nenit 23.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/3 mbi Tatimin në Fitim në Kosovë dhe nenit 24.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;

Duke pasur parasysh nevojën për siguri lidhur me obligimet tatimore të Ndërmarrjeve me Pronësi Shoqërore që janë në procesin e privatizimit,

Duke marrë në konsideratë Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12 Mbi Themelimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit dhe në veçanti autorizimet e dhëna asaj organizate në lidhje me Ndërmarrjet me Pronësi Shoqërore sipas nenit 6 të asaj Rregulloreje,

Me këtë lëshon Udhëzimin Administrativ vijues:

Neni 1

Definicionet

‘Riorganizimi i përjashtuar’ nënkupton çdo riorganizim që nuk i është dhënë miratimi nga Administrata Tatimore. Riorganizimi i tillë i përjashtuar do të trajtohet si një shitje normale e entitetit apo asetëve të tij.

‘AKM’ nënkupton Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit i themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12.

‘Ndërmarrja e Re - NewCo’ nënkupton kompaninë e themeluar të re e formuar si një bijë e zotëruar plotësisht e një NSH në pajtim me Nenin 6.2.a të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12.

‘Riorganizim i kualifikuar’ nënkupton riorganizimin e një NSH të përfshirë në procesin e privatizimit në përputhje me rregullat të përcaktuara nga AKM, në pajtim me planin e shkruar të riorganizimit për qëllime biznesi, ekonomike dhe financiare dhe që nuk ka për qëllim shmangjen e tatimit nga çdo palë apo aksionar. Riorganizimi i kualifikuar aprovohet me shkrim nga Administrata Tatimore e Kosovës.

‘Riorganizim’ përfshinë me sa vijon:

- (a) Ndryshim në formë të një entiteti, apo në emrin e saj apo vendin e organizimit;
- (b) Rikapitalizim i një entiteti;
- (c) Kombinim i dy apo më tepër entiteve në një, qoftë me shkrirje, përthithje, apo ndryshe;
- (d) Ndarja e një entiteti në dy apo më tepër entitete, qoftë me nënndarje, shpërndarje, zhvendosje veprimtarije (spin off) apo ndryshe që (menjëherë pas ndarjes) janë nën kontrollin e entitetit të ndarë, aksionarëve të tij apo të dyjave;
- (e) Blerja e kontrollit të një entiteti në shkëmbim vetëm për interes votimi në entitetin e blerë;
- (f) Blerja në realitet e të gjitha aseteve të një entiteti në shkëmbim vetëm për interes votimi në entitetin e blerë; dhe
- (g) Transferi i disa apo të gjitha aseteve të një NSH në një apo më tepër Ndërmarrje të Reja në pajtim me Neni 8.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12.

‘NSH’ nënkupton Ndërmarrjen me Pronësi Shoqërore ashtu sikurse është përcaktuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12.

Neni 2

Trajtimi i tatimit mbi të drejtat dhe obligimet në rast të procedurës spin off të AKM-së në privatizimin e NSH

Në rast të riorganizimit të kualifikuar të një NSH, ku NSH themelon një apo më tepër Ndërmarrje të Reja, pozita e tatimit të NSH nuk transferohet në Ndërmarrjen(et) e Re(ja) por mbetet në NSH. Për qëllim të fjalisë së kaluar, ‘pozita tatimore’ nënkupton çdo tatim borxh, çdo humbje për tatime apo kredi (zbritje) në tatime për secilën prej tatimeve të zbatueshme në Kosovë por duke mos cenuar të drejtën e AKM-së të caktojë përgjegjësinë mbi Ndërmarrjen(et) e Re(ja) për shlyerje të obligimeve të tilla ashtu siç mund të pajtohet herë pas here në mes të AKM-së dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë apo ashtu siç mund të përcaktohet me ligjin e zbatueshëm.

Neni 3

Marrja e miratimit me shkrim nga Administrata Tatimore

Një NSH e cila është riorganizuar do të kërkojë miratim me shkrim nga Administrata Tatimore e Kosovës se riorganizimi është riorganizim i kualifikuar. Çdo NSH që aplikon për status të riorganizimit të kualifikuar do ta dorëzojë kërkesën me shkrim në Administratën Tatimore duke sqaruar arsyet pse po bëhet riorganizimi, duke theksuar mekanizmin e riorganizimit dhe duke

bërë përmbledhjen e aktivitetit dhe pasivitetit (nëse ka) që do të transferohet. Administrata Tatimore përpara se të të japë miratimin gëzon të drejtën për kontroll të librave dhe regjistrimeve të NSH.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi më Shkurt 2005 dhe zbatohet për vitin 2004 dhe vitet tjera tatimore në të ardhmen.

Haki Shatri

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

